



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Nr. ref.01/2038 / Datë: 07.12.2017

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe vendimin e Këshillit Drejtues të UKZ-së, të mbledhjes XIX të datës 10.11.2017 dhe protokoluar me nr. 02/1876 të datës 29.11.2017, Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan shpall:

KONKURS PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E UKZ-së

Ftohen studentët e UKZ-së që të aplikojnë për punë praktike në Universitetin "Kadri Zeka" Gjiilan.

Puna praktike ka si objektiv që t'ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë, në vendin e punës dhe njëkohësisht të fitojnë përvojë të punës praktike.

Kjo praktikë do t'ju ndihmojë studentëve që t'i zbulojnë fushat e tyre të interesit, si dhe ta kenë më të qartë se në cilën punë specifike dëshirojnë që të punësohen në të ardhmen.

Entuziazmi dhe dedikimi i treguar gjatë praktikës, jo vetëm që do të ndikojë në avancimin profesional të kandidatëve, por gjithashtu do të mund të ndikojnë pozitivisht në gjetjen e punës pas diplomimit.

Numri i pozitave: 10 praktikantë.

Kohëzgjatja e punës praktike: 3 muaj

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike

1. Kandidati i punës praktike duhet të jetë student i rregullt në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan;
2. Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan do të marrë parasysh notën mesatare të studentëve.
3. Studentët që përzgjidhen për të kryer punë praktike duhet të jenë në vitin e dytë (studentët me sistem 3 vjeçar të studimeve), përkatësishtë vitit të tretë të studimeve bachelor (studentët me sistem 4 vjeçar të studimeve), ose të jenë të regjistruar në studimet master.
4. Praktikanti/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit; Njohje të Gjuhës Angleze, Aftësi të mira analitike, Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike; Aftësi të punës në grup; Motiv për t’u vetë zhvilluar dhe të mësoj shpejt.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Një CV;
2. Një letër motivim për punë praktike;
3. Çertifikatën e notave;
4. Vërtetimin mbi statusin e studentit-Master;
5. Kopjen e Letërnjoftimit;
6. Dokument që vërteton njohjen e Gjuhës Angleze;

Kohëzgjatja e konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë.

- Data për aplikim: 07/12/2017 deri më 22/12/2017 në ora 16:00;
- Shpallja e listave do të bëhet me datën: 30 Dhjetor 2017 në faqen zyrtare të Universitetit;
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan. Për kohën e nënshkrimit të kontratës, kandidatët do të informohen përmes e-mailit të dhënë në letër motivim;
- Dokumentet duhen të dorëzohen në Rektoratin e UKZ-së si dhe në formatin elektronik pdf, në email adresën praktika@uni-gjilan.net
- Studentët do të jenë të angazhuar 6 orë në ditë.
- Puna praktike në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan është me pagesë (100€/muaj) neto;
- Praktika për studentët e përzgjedhur do të zgjasë tre muaj (3 muaj), nga data 03 Janar 2017 deri më 31 Mars 2017, me mundësi vazhdimi edhe për tre (3) muaj të tjerë;

Kandidatët që nuk pranohen në këtë konkurs për praktikantë kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UKZ-së, pa kurrfarë diskriminimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Praktikantët në përfundim të programit të punës praktike do të pajisen me Referencë dhe Certifikatë nga: Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan.